

KUSHTET E PËRGJITHSHME “TELESHËNDET”

GENERAT CONDITIONS

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, me numër identifikimi unik të subjektit (NUIS): J91809007H (më tej referuar si “**SIGAL**”), është një shoqëri sigurimi e licencuar që operon në përputhje me ligjin shqiptar, duke ofruar të gjitha klasat e sigurimit. Si një veçori e produkteve të saj, përfshihet edhe shërbimi i platformës **Teleshëndet Albania Shpk** — një platformë burimore e ndërtuar për të përmirësuar mirëqenien tuaj përmes një rrjeti mjekësh, të cilët veprojnë në emër të tyre dhe për llogari të tyre, si mjekë të licencuar, duke ofruar konsultime mjekësore në distancë. Megjithatë, në asnjë rast, ndërveprimi juaj me mjekët — të cilët kontaktohen përmes platformës elektronike **Teleshëndet** — nuk synon të zëvendësojë marrëdhëniet tuaja me mjekët tuaj të rregullt ose ata që mbulohen nga kontratat tuaja aktive të sigurimit. Nëse gjendeni në një emergjencë mjekësore, ju lutemi kontaktoni shërbimin e urgjencës mjekësore në numrin 127. Ne ju rekomandojmë dhe ju kërkujmë me forcë që të lexoni dhe kuptoni me kujdes këto **Kushte Shërbimi** para se t'i pranoni dhe, rrjedhimisht, para se të përdorni shërbimet që ofrohen në to. Duke pranuar dhe zbatuar këto **Kushte Shërbimi** dhe/ose duke kërkuar shërbimet që ofrohen në to, ju pranoni dhe pajtoheni që **SIGAL** dhe **TeleShëndet** nuk mbajnë asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim të çfarëdo lloji, që mund të lindë në të ardhmen, nga ose në lidhje me këto shërbime, mbi bazën e argumentit dhe/ose faktit, si dhe/ose pretendimit, se nuk i keni lexuar dhe/ose kuptuar këto Kushte Shërbimi.

1 – PËRKUFTIME

1.1 Në dispozitat e këtyre **Kushteve të Shërbimit** (siç përkufizohet më poshtë), përveç rasteve kur konteksti tregon qartë ndryshe, zbatohen përkufizimet e këtij Neni 1: 1.1.1 “**Shërbime të Telemedicinës**” – nënkupton të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor në distancë dhe konsultat shëndetësore përmes telefonit/video, si dhe çdo shërbim tjetër të personalizuar lidhur me shëndetin, të kërkuar nga Klienti. Kanale komunikimi për këto qëllime janë: linja telefonike, interneti, aplikacioni mobil dhe/ose aplikacioni tablet **Teleshëndet** (“App”); 1.1.2 “**Ofertues Shërbimi Shëndetësor**” – nënkupton të gjithë mjekët, specialistët dhe/ose nën-specialistët që ofrojnë **Shërbime të Telemedicinës** për Klientët, bazuar në dispozitat e këtyre Kushteve dhe marrëveshjet përkatëse të nënshkruara ndërmjet Ofertuesit dhe **TeleShëndet**; 1.1.3 “**Klienti**” – nënkupton individin që përfiton nga Shërbimet e Telemedicinës sipas këtyre Kushteve, për veten dhe/ose anëtarët e familjes (plani familjar); 1.1.4 “**Kushtet e Shërbimit**” – i referohen këtij dokumenti dhe dokumenteve bashkëlidhur; 1.1.5 “**Tarifa**” – shuma monetare vjetore e paguar nga Klienti për të përfituar Shërbimet e Telemedicinës; 1.1.6 “**Primi i Sigurimit**” – shuma monetare vjetore e paguar nga i siguruari për të marrë një kontratë sigurimi, që përfshin gjithashtu edhe shërbimin **Teleshëndet**; 1.1.7 “**Data e Fillimit**” – nënkupton datën kur Klienti nënshkruan Deklaratën Paraprake të Pëlqimit, sipas Aneksit 1 të bashkëlidhur me këto Kushte; 1.1.8 “**Periodua e Vlefshmërisë**” – çdo periudhë një (1) vjeçare e këtyre Kushteve, duke filluar nga Data e Fillimit deri në datën e skadimit të policës së sigurimit ose të kartës së parapaguar për këtë shërbim; 1.1.9 “**Kohëzgjatja**” – i referohet kolektivisht të gjitha Periudhave të Vlefshmërisë së këtyre Kushteve; 1.1.10 “**Administratori i Palës së Tretë**” ose “**TPA**” – nënkupton entitetin nga i cili Klienti do të blejë produktet e nevojshme për të pasur akses në Shërbimet e Telemedicinës; 1.1.11 “**Të Dhëna Mjekësore**” – pa paragjykuar dispozitat e tjera të këtyre Kushteve, nënkupton të dhënat personale shëndetësore të nevojshme për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnozës, ofrimit të shërbimeve shëndetësore, trajtimit ose menaxhimit të shërbimeve shëndetësore, si dhe të dhënat e përdorura nga Ofertuesit dhe/ose persona të tjerë të detyruar për ruajtje konfidencialiteti; 1.1.12 “**Legjislacioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**” – Ligji nr. 124/2024, datë 19.12.2024, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse të nxjerra nga qeveria dhe/ose Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave”); 1.2 Përveç përkufizimeve të përcaktuara në pikën 1.1 më sipër, të gjithë termat e përmendur në këto **Kushte Shërbimi** do të kenë kuptimin e dhënë në dispozitat përkatëse ose, në mungesë të një përkufizimi specifik, kuptimin që shërben për realizimin e qëllimit të këtyre Kushteve.

2 – AFTËSIA LIGJORE PËR TË VEPRUAR

Klienti deklaron dhe garanton që ai/ajo ka të drejtën ligjore dhe aftësinë e plotë për të vepruar në emër të tij/saj dhe/ose në emër të një fëmije të mitur, prindi apo personi në ngarkim për të cilin ai/ajo është kujdestar ligjor. Bazuar në vullnetin e tij/saj të lirë, Klienti pranon, pajtohet dhe zbaton dispozitat e këtyre **Kushteve të Shërbimit**.

3 – SHËRBIMET E TELEMEDICINËS

3.1 Gjatë Kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë jo-ekskluzive, **TeleShëndet** i mundëson Klientit të marrë, përmes Ofertuesve të Shërbimit Shëndetësor, Shërbimet e Telemedicinës të kërkuara për veten dhe/ose për anëtarët e familjes (plani familjar). 3.2 **TeleShëndet** ofron mbulim shëndetësor për individë bazuar në paketa të ndryshme të publikuara në faqen zyrtare të internetit: www.teleshendet.al. 3.3 Shërbimet e Telemedicinës, të ofruara përmes **TeleShëndet**, do të jenë të disponueshme 24 (njëzet e katër) orë në ditë, 7 (shtatë) ditë në javë dhe 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë në vit. 3.4 Shërbimet e Telemedicinës mund të aksesohen si më poshtë: 3.4.1 Online: (i) Audio/Video: Konsultë me video me një Ofertues Shërbimi Shëndetësor, duke përdorur sistemin e sigurt të videos së **TeleShëndet**. Kjo kërkon plotësimin e një vlerësimi mjekësor dhe pyetësorit të historisë shëndetësore për të vendosur marrëdhënien mjek-pacient dhe për të përcaktuar trajtimin e duhur.

4 – DETYRIMET E PALEVE

4.1 Gjatë Kohëzgjatjes së këtyre Kushteve të Shërbimit, **TeleShëndet** do të: 4.1.1 mundësojë ofrimin dhe mbështetjen e Shërbimeve të Telemedicinës të ofruara nga Ofertuesit; 4.1.2 administrojë dhe mbajë në mënyrë të sigurt një bazë të dhënash me të dhënat e profilizuara të dhëna nga Klienti, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, përfshirë por jo vetëm Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. 4.2 Gjatë Kohëzgjatjes së këtyre Kushteve të Shërbimit, Klienti do të: 4.2.1 dorëzojë të **TeleShëndet**, ose të Administratori i Palës së Tretë i caktuar, të gjitha informacionet e nevojshme për regjistrim; 4.2.2 kryejë të gjitha pagesat e zbatueshme ndaj **TeleShëndet**; 4.2.3 përdorë Shërbimet e Telemedicinës në përputhje me këto Kushte Shërbimi.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, with unique entity identification number (NUIS): J91809007H (hereinafter referred to as “**SIGAL**”), is a licensed insurance company operating in accordance with Albanian Law, offering all classes of insurance. As a feature of its products, it includes the service of the **Teleshëndet Albania Shpk** platform — a resource platform built to improve your well-being through a network of doctors, who will act in their own name and on their own account, as licensed physicians, in providing relevant remote medical consultations. However, in any case, your interaction with doctors — who are contacted through the **TeleShëndet** electronic platform — is not intended to replace your relationship(s) with your regular doctor(s), or those covered by your active insurance contracts. If you find yourself in a medical emergency, please contact the medical emergency service at number 127. We strongly recommend and request that you carefully review and understand these Terms of Service before accepting them and, consequently, before using the services provided therein. By accepting and adhering to these Terms of Service and/or by requesting the services provided therein, you acknowledge and agree that **SIGAL** and **TeleShëndet** bear no responsibility and/or obligation of any kind, which may arise in the future, from or in connection with these services, based on the argument and/or fact, as well as/or claim, that you did not read and/or understand these Terms of Service.

1-DEFINITIONS

1.1. In the provisions of these Terms of Service (as defined below), except where clearly indicated by context, the definitions in this Article 1 shall apply: 1.1.1 “**Telemedicine Services**” – means all remote healthcare services and health consultations via telephone/video, as well as any personalized health-related service requested by the Client. The communication channels for the purposes of Telemedicine Services shall include telephone line, internet, mobile application, and/or **Teleshëndet** tablet application (“App”); 1.1.2 “**Healthcare Provider**” – means all healthcare physicians, specialists, and/or subspecialists who provide Telemedicine Services to Clients, based on the provisions of these Terms of Service and the relevant service agreements signed between the Healthcare Providers and **Teleshëndet** for this purpose; 1.1.3 “**Client**” – means the individual who benefits from the Telemedicine Services under these Terms of Service, for themselves and/or their family members (family plan); “**Terms of Service**” – refers to this document and the documents attached hereto; 1.1.5 “**Fee**” – refers to the annual monetary amount paid by the Client to benefit from Telemedicine Services; 1.1.6 “**Insurance Premium**” – refers to the annual monetary amount paid by the insured person to obtain an insurance contract, which also includes the **Teleshëndet** service. 1.1.6 “**Effective Date**” – means the date on which the Client signs the Preliminary Consent Statement, as per Annex 1 attached to these Terms of Service; 1.1.7 “**Effective Period**” – means each one (1) year period of these Terms of Service, starting from their Effective Date until the expiry date of the insurance policy or the expiration date of the prepaid card for this service; 1.1.8 “**Duration**” – collectively refers to all Effective Periods of these Terms of Service; 1.1.9 “**Third Party Administrator**” or “**TPA**” – means the entity from which the Client will purchase the necessary products in order to access the Telemedicine Services; 1.1.10 “**Medical Data**” – without prejudice to any other provisions of these Terms of Service, means the personal health information required for the purposes of preventive medicine, medical diagnosis, provision of healthcare services, treatment or management of healthcare services, as well as the data used by Healthcare Providers and/or other persons obligated to maintain confidentiality; 1.1.11 “**Personal Data Protection Legislation**” – means Law no. 124/2024, dated 19.12.2024, “On the Protection of Personal Data,” as amended (hereinafter referred to as the “**Personal Data Protection Law**”), as well as relevant secondary legislation issued by the government and/or the Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data (hereinafter, the “**Data Protection Commissioner**”) pursuant to the **Personal Data Protection Law**. 1.2 Without prejudice to the definitions set out in paragraph 1.1 above, all terms and/or definitions mentioned in these Terms of Service shall have the meaning given to them in the relevant provisions or, in the absence of a specific definition, the meaning that serves to fulfill the purpose of these Terms of Service.

2. **LEGAL CAPACITY TO ACT** The Client declares and warrants that he/she has the legal right and full legal capacity to act on his/her own behalf and/or on behalf of a minor child, parent, or dependent for whom he/she is the legal guardian. Based on his/her own free will, the Client accepts, agrees to, and adheres to the provisions of these Terms of Service.

3. TELEMEDICINE SERVICES

3.1 During the Duration of this Agreement, and on a non-exclusive basis, **TeleShëndet** enables the Client to receive, through Healthcare Providers, the Telemedicine Services requested by the Client for himself/herself and/or his/her family members (family plan). 3.2 **TeleShëndet** offers health coverage to individuals based on different packages published on its official website: www.teleshendet.al. 3.3 The Telemedicine Services, provided via **TeleShëndet**, will be available 24 (twenty-four) hours a day, 7 (seven) days a week, and 365 (three hundred sixty-five) days a year. 3.4 The Telemedicine Services may be accessed as follows: 3.4.1 Online: (i) Audio/Video: Consultation via video with a Healthcare Provider, using **TeleShëndet**'s secure video system. This requires completion of a medical assessment and health history questionnaire in order to establish a doctor-patient relationship and determine the appropriate course of treatment.

4. OBLIGATIONS OF THE PARTIES

4.1 During the Duration of these Terms of Service, **TeleShëndet** shall: 4.1.1 facilitate the provision and support of the Telemedicine Services delivered by Healthcare Providers; 4.1.2 securely manage and maintain a database of profiled information

5 – ÇMIMI DHE PAGESA

5.1 Klienti do të paguajë Tarifën për përdorimin e Shërbimeve të Telemedicinës, qoftë drejtpërdrejt ose si pjesë e përfshirë falas në produktet e sigurimit të ofruara nga **SIGAL**. **5.2** Çdo pagesë që nuk merret nga **TeleShëndet**, ose Administratori i Palës së Trejtë i caktuar, në ose para datës së pagesës, do të rezultojë në pezullimin e menjëhershëm të Shërbimeve të Telemedicinës. **5.3** **SIGAL** rezervon të drejtën të ndryshojë Tarifën për çdo Periudhë Vlefshmërie të ardhshme, duke i dhënë Klientit një njoftim me shkrim të paktën dhjetë (10) ditë para fundit të Periudhës përkatëse të Vlefshmërisë. **5.4** Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këto Kushte, Klienti pranon dhe pajtohet që shumave të paguara **SIGAL-it**, sipas përcaktimeve të tij, nuk u bëhet rimbursim dhe nuk i nënshtrohen kompensimit, zbritjes apo ndonjë pretendimi tjetër.

6 – KOHËZGJATJA DHE NDËRPRERJA

6.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këto Kushte Shërbimi, ato mbeten në fuqi për një periudhë prej një (1) viti, deri në datën e skadimit të policës përkatëse të sigurimit dhe do të rinovohen, aktivisht/automatikisht, për periudha shtesë një (1) vjeçare në çdo përvjetor të Datës së Fillimit. **6.2** Çdo palë mund t'i ndërpresë këto Kushte Shërbimi në çdo kohë, duke i dërguar palës tjetër një njoftim me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë përpara. Në rast ndërprerjeje të parakohshme të këtyre Kushteve, për çdo arsye që nuk lidhet me veprimet dhe/ose mosveprimet e **TeleShëndet**, zbatohen dispozitat e pikës 5.4 të Nenit 5 më sipër.

7 – PRONËSIA INTELEKTUALE

7.1 Të gjitha të drejtat mbi emrat e produkteve, emrat e kompanive, emrat tregtarë, logot, sloganet, paketimin e produkteve dhe dizajnet e Shërbimeve të Telemedicinës – qofshin ose jo të paraqitura me shkronja të mëdha apo simbole marke tregtare – i përkasin ekskluzivisht **TeleShëndet** ose licencuesve të saj dhe mbrohen nga riprodhimi, imitimi, shpërdorimi ose përdorimi mashtrues/konfuz në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare për pronësinë industriale dhe të drejtën e autorit. **7.2** Përdorimi ose keqpërdorimi i këtyre markave tregtare ose i materialeve të lidhura me to, përveç rasteve të autorizuar qartë në këto Kushte, është i ndaluar repretishtë. Asgjë e përfshirë ose e nënkuptuar në Shërbimet e Telemedicinës nuk i jep Klientit ndonjë licencë ose të drejtë nën patentat ose markat tregtare të **TeleShëndet**, filialeve të saj ose ndonjë pale të tretë. **7.3** Klienti nuk do të publikojë, riprodhojë, shpërndajë, shfaqë, interpretojë, redaktojë, përshtasë, modifikojë ose të shfrytëzojë ndonjë pjesë të Shërbimeve të Telemedicinës pa pëlqimin paraprak me shkrim të **TeleShëndet**.

8 – MBROJTJA E TË DHËNAVE

8.1 Klienti pranon, kupton dhe pajtohet që, për qëllimin e marrjes së Shërbimeve të Telemedicinës, ai/ajo do të japë të dhënat personale si dhe të Dhënat Mjekësore tek Ofertuesi përkatës i Shërbimit Shëndetësor. Klienti pranon, kupton dhe pajtohet që përpunimi i të dhënave personale është vullnetar; megjithatë, ky përpunim do të kryhet gjithashtu në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili përcakton detyrimet e kontrolluesit të të dhënave lidhur me raportimin dhe ruajtjen e të dhënave. **TeleShëndet** vepron si kontrollues i të dhënave personale, të cilat përpunohen nga Ofertuesit dhe stafi tjetër administrativ i **TeleShëndet**. **8.2** Përveç asaj që parashikohet në pikën 8.1 më sipër, Klienti pranon, kupton dhe pajtohet gjithashtu që: **8.2.1** Shërbimet e Telemedicinës përfshijnë komunikimin elektronik të të Dhënave Personale dhe Mjekësore të Klientit; **8.2.2** Përpunimi (përfshirë, por jo vetëm mbledhjen, organizimin, ruajtjen, transmetimin, etj.) i të Dhënave Personale dhe/ose Mjekësore do të kryhet në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; **8.2.3** Të Dhënat Mjekësore do të përpunohen kryesisht nga Ofertuesi përkatës i Shërbimit Shëndetësor, i cili do të regjistrojë vetëm të dhënat e nevojshme mjekësore dhe do të krijojë një kartelë personale për çdo pacient, e cila do të ruhet në sistemin **TeleShëndet** për periudhat e përcaktuara në Kapitullin III (Ruajtja e të Dhënave Personale) të Udhëzimit Nr. 2, datë 30.04.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë" ("Udhëzimi Nr. 2"); **8.2.4** Të Dhënat Mjekësore mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, historikun mjekësor, gjendjen aktuale shëndetësore të Klientit dhe/ose anëtarëve të familjes (plani familjar); **8.2.5** Përpunimi i të Dhënave Personale dhe Mjekësore do të kryhet vetëm për qëllimin e ofrimit të Shërbimeve të Telemedicinës nga Ofertuesit, këshillimi i të cilëve mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në mjekësinë parandaluese, diagnostikimin shëndetësor, ofrimin e kujdesit shëndetësor, trajtimin dhe menaxhimin e shërbimeve shëndetësore; **8.2.6** **TeleShëndet** do të ruajë dhe mbajë të Dhënat Personale dhe Mjekësore në një bazë të dhënash elektronike të sigurt dhe të dedikuar, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, siç përcaktohet, ndër të tjera, në nën-pikën 8.2.3 më sipër. Për këtë qëllim, **TeleShëndet** garanton një sistem të sigurt për mbledhjen dhe përpunimin e të Dhënave Mjekësore; **8.2.7** Me iniciativën e **TeleShëndet** dhe/ose me kërkesën e Klientit, **TeleShëndet** do të bllokojë, korrigjojë ose fshijë të Dhënat Personale dhe/ose Mjekësore nëse ato rezultojnë të pasakta, të rreme, të paplota dhe/ose janë përpunuar në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. **8.3** Pa paragjykur dispozitat e këtyre Kushteve të Shërbimit dhe/ose Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Klienti gëzon gjithashtu të drejtat e mëposhtme: **8.3.1** Të marrë një kopje të të Dhënave të tij/saj Personale dhe Mjekësore që mbahen nga **TeleShëndet**; **8.3.2** Të kërkojë akses dhe/ose korrigjim, bllokim ose fshirje të të Dhënave të tij/saj Personale dhe/ose Mjekësore, të tërheqë pëlqimin për përpunim të mëtejshëm dhe/ose të kërkojë kufizim ose kundërshtim të përpunimit të tyre të mëtejshëm. Për këtë qëllim, **TeleShëndet** do t'i përgjigjet dhe trajtojë kërkesat e Klientit brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike, sipas parashikimeve të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Klienti do të paraqesë kërkesa në formën e specifikuar në Nenin 13 të këtyre Kushteve të Shërbimit. **8.4** Klienti jep pëlqimin e tij/saj që **TeleShëndet** të transferojë të Dhënat e tij/saj Personale dhe Mjekësore te palë të treta, brenda dhe/ose jashtë Shqipërisë, në masën që është e nevojshme për përmbushjen e duhur të Shërbimeve të Telemedicinës, por në çdo rast, në përputhje me, por pa u kufizuar vetëm në, Nenin 7 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Udhëzimin Nr. 2 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave. **8.5** Dispozitat e këtij Neni 8 të Kushteve të Shërbimit do të lexohen dhe interpretohen në përputhje me Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për çdo çështje që nuk mbulohet këtu, do të zbatohen dispozitat e këtij

provided by the Client, in accordance with applicable Albanian legislation, including but not limited to the Personal Data Protection Legislation. 4.2 During the Duration of these Terms of Service, the Client shall: 4.2.1 submit to TeleShëndet, or to the designated Third Party Administrator (TPA), the required registration information; 4.2.2 make all applicable payments to TeleShëndet; 4.2.3 use the Telemedicine Services in accordance with these Terms of Service.

5. PRICE AND PAYMENT

5.1 The Client shall pay the Fee for the use of the Telemedicine Services, either directly or as included free of charge through insurance products provided by SIGAL. 5.2 Any payment not received by TeleShëndet, or its designated TPA, on or before the due date shall result in the immediate suspension of the Telemedicine Services. 5.3 SIGAL reserves the right to change the Fee for any future Effective Period, by providing the Client with written notice at least ten (10) days prior to the end of the relevant Effective Period. 5.4 Except as otherwise provided by these Terms of Service, the Client acknowledges and agrees that the amounts paid to SIGAL, as determined by the latter, are non-refundable and not subject to set-off, deduction, or any other claim.

6. DURATION AND TERMINATION

6.1 Unless otherwise specified in these Terms of Service, they shall remain in force for a period of one (1) year, until the expiration date of the relevant insurance policy, and shall be renewed, actively/automatically, for additional one (1) year periods on each anniversary of the Effective Date. 6.2 Each party may terminate these Terms of Service at any time, by providing the other party with written notice at least thirty (30) days in advance. In the event of early termination of these Terms of Service, for any reason not related to the actions and/or omissions of TeleShëndet, the provisions of paragraph 5.4 of Article 5 above shall apply.

7. INTELLECTUAL PROPERTY

7.1 All rights to product names, company names, trade names, logos, slogans, product packaging, and designs of the Telemedicine Services—whether or not presented in capital letters or with trademark symbols—belong exclusively to TeleShëndet or its licensors and are protected from reproduction, imitation, dilution, or misleading/confusing use, in accordance with national and international laws on industrial property and copyright. 7.2 The use or misuse of these trademarks or any related materials, except as expressly authorized herein, is strictly prohibited. Nothing stated or implied in the Telemedicine Services grants the Client any license or right under the patents or trademarks of TeleShëndet, its affiliates, or any third party. 7.3 The Client shall not publish, reproduce, distribute, display, perform, edit, adapt, modify, or otherwise exploit any part of the Telemedicine Services without the prior written consent of TeleShëndet.

8. DATA PROTECTION

8.1 The Client acknowledges, understands, and agrees that, for the purpose of receiving Telemedicine Services, he/she shall provide his/her personal data as well as Medical Data to the relevant Healthcare Provider. The Client acknowledges, understands, and agrees that the processing of his/her personal data is voluntary; however, such processing shall also be carried out in accordance with the provisions of the Personal Data Protection Legislation, which sets forth the obligations of the data controller regarding data reporting and retention. TeleShëndet shall act as the data controller of the personal data, which shall be processed by the Healthcare Providers and other administrative personnel of TeleShëndet. 8.2 In addition to what is provided in paragraph 8.1 above, the Client acknowledges, understands, and agrees to the following: 8.2.1 Telemedicine Services involve the electronic communication of the Client's personal and Medical Data; 8.2.2 The processing (including but not limited to collection, organization, storage, transmission, etc.) of personal and/or Medical Data shall be carried out in full compliance with the Personal Data Protection Legislation; 8.2.3 Medical Data shall primarily be processed by the relevant Healthcare Provider, who will record only the necessary Medical Data and create a personal file for each patient, which will be stored in the TeleShëndet system for the periods defined in Chapter III (Retention of Personal Data) of Instruction No. 2 dated on 30.04.2025, of the Commissioner for Personal Data Protection "On the processing of personal data in the healthcare sector" (hereinafter referred to as "Instruction No. 2"); 8.2.4 Medical Data may include, but are not limited to, medical history, current health condition of the Client and/or his/her family members (family plan), etc.; 8.2.5 The processing of personal and Medical Data shall be carried out solely for the purpose of providing Telemedicine Services by the Healthcare Providers, whose advice may include, but is not limited to, preventive medicine, health diagnostics, delivery of healthcare, treatment, and management of healthcare services; 8.2.6 TeleShëndet shall store and retain personal and Medical Data in a secure and dedicated electronic database, in compliance with the provisions of the Personal Data Protection Legislation, as defined, among others, in subparagraph 8.2.3 above. For this purpose, TeleShëndet guarantees a secure system for the collection and processing of Medical Data; 8.2.7 Upon the initiative of TeleShëndet and/or at the Client's request, TeleShëndet shall block, rectify, or delete personal and/or Medical Data if such data are found to be inaccurate, false, incomplete, and/or have been processed in violation of the provisions of the Personal Data Protection Legislation. 8.3 Without prejudice to the provisions of these Terms of Service and/or the Personal Data Protection Legislation, the Client shall also enjoy the following rights: 8.3.1 To obtain a copy of his/her personal and Medical Data retained by TeleShëndet; 8.3.2 To request access to and/or rectification, blocking, or deletion of his/her personal and/or Medical Data, to withdraw consent for further processing of such data, and/or to request the restriction or object to their further processing. For this purpose, TeleShëndet shall respond to and address the Client's requests within thirty (30) calendar days, as provided by the Personal Data Protection Legislation. The Client shall submit such requests in the form specified in Article 13 of these Terms of Service. 8.4 The Client gives his/her consent to TeleShëndet for the transfer of his/her personal and Medical Data to third parties, within and/or outside of Albania, to the extent necessary for the proper fulfillment of Telemedicine Services, but in any case, in accordance with, but not limited to, Article

